



e Rahovecit

Përmbushet edhe një zotim publik - përkrahja e bujqve me inpute bujqësore

Komuna e Rahovecit po i përkrah drejtpërdrejt bujqit, ku sot filloi me shpërndarjen e plehut artificial për 1128 bujq përfitues, sipas kriterëve të përcaktuara nga DBPZhR-ja. Në fazën e parë, plehu do të shpërndahet për 547 bujq, të cilët kanë nënshkruar kontratë deri më 30 qershor 2024. Në këtë proces do të bëhet shpërndarja e gjithsej 10,000 (dhjetë mijë) thasëve me pleh artificial.



NËNSHKRUHET KONTRATA PËR FINANCIMIN E FESTËS SË VJELJES SË RRUSHIT "HARDH FEST" 2024

Komuna e Rahovecit, bashkë me drejtorin ekzekutiv i Shoqatës "Hardh Fest", nënshkruan një kontratë të rëndësishme për financimin e Festës së Vjeljes së Rrushit "Hardh Fest" 2024, i cili do të mbahet më 6, 7 dhe 8 shtator 2024. Kjo festë e madhe do të vazhdojë të mbetet një ndër ngjarjet më të mëdha kulturore, e cila do të bëjë bashkë adhurues të shumtë në një festë të rrallë për kulturën dhe trashëgiminë tonë bujqësore.

Vazhdojnë përrurimet e fushave sportive në komunën e Rahovecit

Në hapësirën e ShFMU “Bajram Curri” në Krushë të Madhe, u përruruan mjediset e reja sportive për futboll, basketboll dhe volejbol.

Është fusha e parë me shtresë gome (tartan) në komunën tonë.



Në hapësirën e ShFMU “Rilindja” në Çifllak u përruruan mjediset sportive për futboll, basketboll dhe volejbol.



Në hapësirën e ShFMU “Rudolf Walther”, paralelja e ndarë në Dobidol, u përruruan tri investime shumë të rëndësishme për të rinjtë:

- Mjediset sportive për futboll, basketboll dhe volejbol;
- Riparimin e brendshëm dhe të jashtëm të objektit dhe
- Rrethojën e oborrit të shkollës në Dobidol.

Vlen të përmendet që projekti i mjedisit sportiv është bashkëfinancim me Organizatën "Advancing Together" dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim.

